

BASHKIA VAU DEJËS
NJOFTIM DHËNIE ME QIRA

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vau Dejës

Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës

Tel/Fax 0035526120006

E-mail: info@vaudejes.gov.al

1. Dhënie në përdorim me anë të konkurimit të sipërfaqes prej 1 ha, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, e llojit "Pa fryt", në pronësi të Bashkisë Vau Dejës, ndodhur në fshatin Stajkë, Nj.Ad Bushat, Bashkia Vau Dejës.

Procedurat do kryhen sipas VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr 13, datë 26.04.2018, "Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", ndryshuar.

2. Çmimi dysheme i fillimit të konkurimit është 27 000 lekë/ha, në vit, bazuar në pikën 34, të Udhëzimit nr 13, datë 26.04.20218, "Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës, e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", ndryshuar.

Afati i dhënies në përdorim është deri 10 vjet.

3. Qëllimi i përdorimit është dhënia në gëzim të përkohshëm e sipërfaqes prej 1 ha, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, e llojit "Pa fryt", për veprimtari në fushën e blegtorisë dhe agropërpunimit.

4. Pikët vlerësuese sipas kriterëve të konkurimit për subjektet pjesëmarrës do të jenë:

Nr	Kriteret e konkurimit	Pikët vlerësuese për elementet e konkurimit
1	Niveli i investimit	30 pikë
2	Niveli i punësimit	30 pikë
3	Oferta e detyrimit mujor/vjetor të qirasë	40 pikë

5. Dokumentacioni që duhet të plotësohet nga konkurentët pjesëmarrës është:

Personat fizik dhe juridik që marrin pjesë në konkurim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesën e subjektit bashkë me gjeneralitetet për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku në të, të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit vjetor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurimit të parashikuar sipas planit të biznesit.
- Plan biznesin e hollësishëm për vënien në funksion të pronës, në të cilin duhet të përshkruhet qartë: plani i punësimit, plani i investimeve, treguesit që do realizohen brenda një periudhe jo më të gjatë se $\frac{1}{4}$ e afatit të kontratës, të cilat duhet të ruhen deri në fund të afatit të kontratës, si dhe siglen dhe vulën e administratorit të shoqërisë, ose personit fizik, në çdo faqe të tij.
- Deklaratat në formën e vetëdeklarimit ku të përfshihet informacioni i mëposhtëm:
 - Deklaratë mbi NIPT/NUIS-in e subjektit kërkues.

- Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore.
- Deklaratë mbi administratorin dhe subjektin ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

Në rastet kur subjekti konkurses zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte pronë shtetërore, të deklarojë shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt të theksojë se nuk ushtron aktivitet në pronë shtetërore.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

6. Vendi i zhvillimit të konkurimit: Adresa: Bashkisa Vau Dejës, Zyra e Sektorit të Aseteve.

7. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: Datë 13.01.2025, ora 11.00.

8. Kërkesa për pjesëmarrje në konkurim, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatët blerës në kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e konkurimit.